



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
MINISTRI

Nr. 6285 / prot.

Tiranë, më 21.08.2026

URDHËR

Nr. 434, datë 21.08.2026

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR PROCEDURAT E
HETIMIT ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMEVE DHE MASAT PËR
MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË MINISTRINË E ARSIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 14, të pikës 8, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe të vendimit nr. 395, datë 28.5.2026 të Këshillit të Ministrave "Për marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike",

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullore së brendshme për procedurat e hetimit administrativ të sinjalizimeve dhe masat për mbrojtjen e konfidencialitetit në Ministrinë e Arsimit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Rregullore e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për hetimin administrativ dhe ruajtjen e konfidencialitetin, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 948/1 prot., datë 30.01.2018, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E
SINJALIZUESVE

**RREGULLORE E BRENDSHME PËR HETIMIN
ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMEVE DHE
MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË MINISTRINË
E ARSIMIT**

Neni 1

Kuadri ligjor i zbatueshëm

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe për mbrojtjen e konfidencialitetit në Ministrinë e Arsimit bazohet në ligjin nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 28.5.2026 *“Për marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike”*.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ndjekjen e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimeve nga njësia përgjegjëse e ngritur në Ministrinë e Arsimit si dhe i mekanizmave për mbrojtjen e konfidencialitetit, në përputhje me ligjin nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për trajtimin e sinjalizimeve, zhvillimin e hetimit administrativ dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesve dhe personave të përfshirë në Ministrinë e Arsimit, si dhe në institucionet e saj të varësisë me më pak se 50 punonjës. Funksionet e njësisë përgjegjëse për institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit me më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës ushtrohen nga njësia përgjegjëse e Ministrisë së Arsimit.

Neni 4

Përkufizime

Në funksion të objektit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Sinjalizim” është raportimi ose publikimi nga sinjalizuesi i informacionit për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, nëpërmjet mekanizmit të brendshëm, mekanizmit të jashtëm ose publikimit, në përputhje me ligjin nr. 96/2025;
- b) “Sinjalizim i brendshëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi në njësisë përgjegjëse të Ministrisë;

c) “Sinjalizues” është çdo person fizik që në një kontekst pune sinjalizon ose publikon informacione për shkelje të mundshme;

ç) “Njësia përgjegjëse” është struktura e posaçme e caktuar në Ministrinë e Arsimit për marrjen, trajtimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, sipas ligjit nr. 96/2025.

Njësia përgjegjëse ushtron gjithashtu funksionet e saj edhe për institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, të cilat kanë më pak se 50 punonjës.

d) “Person i përfshirë” është çdo person fizik ose juridik, që përmendet në sinjalizim, ose publikim si personi të cilit i atribuohet shkelja ose që ka lidhje me autorin e shkeljes;

dh) “Informacion për shkeljet” është çdo informacion që përmban dyshime të arsyeshme për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen në Ministri dhe/ose në institucionet e varësisë, i siguruar në një kontekst pune.

e) “Kontekst pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme, përmes së cilës një person, pavarësisht nga natyra e saj juridike, ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfshirë marrëdhëniet e punësimit ose të vetëpunësimit, ofrimin e shërbimeve dhe marrëdhënie të tjera bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit ose institucionet e saj të varësisë.

Neni 5

Parimet e shqyrtimit administrativ

Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, ushtron funksionet e saj mbi bazën e këtyre parimeve:

- a) të ndershmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizuesit;
- b) pavarësisë nga ndikimi politik dhe çdo ndikim tjetër i padrejtë që mund të pengojë ushtrimin e detyrave;
- c) shmangies së konfliktit të interesit përpara fillimit të hetimit administrativ;
- d) mbrojtjes së dokumentacionit dhe provave që lidhen me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi ose çdo veprim tjetër që synon asgjësimin e tyre;
- e) ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave që përmban sinjalizimi;
- f) ruajtjes së sekretit shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- g) mbrojtjes së të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit, nëpërmjet mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm;
- h) zhvillimit dhe përfundimit të procedurës së hetimit administrativ në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi i brendshëm në njësinë përgjegjëse të MA mund të bëhet:
 - a) me shkrim, nëpërmjet depozitimit fizik në regjistrin e posaçëm;
 - b) nëpërmjet adresës elektronike të dedikuar;
 - c) në mënyrë verbale, përmes takimit fizik ose linjës telefonike të dedikuar;
 - d) në mënyrë anonime.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a) të dhënat e identitetit dhe kontaktet e sinjalizuesit, me përjashtim të rasteve kur sinjalizimi është kryer në mënyrë anonime;
 - b) organin ose personin e përfshirë ndaj të cilit kryhet sinjalizimi;
 - c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprime të kundërligjshme apo shkelje të kuadrit ligjor, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - d) referimin, për aq sa është e mundur, të parashikimeve të legjislacionit, për të cilat parashtrohet shkelja apo veprimi i kundërligjshëm;
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi anonim pranohet dhe trajtohet kur përmban informacion, të dhëna ose prova të mjaftueshme për të mundësuar verifikimin paraprak dhe hetimin administrativ.
4. Identiteti i sinjalizuesit, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur, ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.
5. Sinjalizimi verbal dokumentohet me procesverbal, i cili nënshkruhet nga sinjalizuesi, kur ky i fundit zgjedh të mos mbetet anonim.
6. Çdo sinjalizim regjistrohet në një regjistër të posaçëm, me akses të kufizuar, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.
7. Sinjalizuesit i konfirmohet marrja e sinjalizimit brenda 7 (shtatë) ditëve nga regjistrimi, përveç rasteve kur ai ka kërkuar të mos njoftohet ose kur njoftimi rrezikon konfidencialitetin.
8. Në rastet kur sinjalizimi nuk përmbush kërkesat sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë të metat, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.
Në rast se sinjalizuesi nuk korrigjon të metat brenda afatit të përcaktuar, njësia përgjegjëse vendos mos fillimin e hetimit administrativ.
9. Përveç sinjalizimit të brendshëm, sinjalizuesi ka mundësinë e raportimit të jashtëm në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Sinjalizimi i jashtëm paraqitet pranë ILDKPKI-së dhe mund të bëhet në çdo fazë, pa qenë i kushtëzuar nga sinjalizimi i brendshëm.

Neni 7

Dokumentimi i sinjalizimit verbal

1. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të regjistruara, sinjalizuesi informohet paraprakisht për regjistrimin. Sinjalizimi dokumentohet nëpërmjet një regjistrimi zanor në pajisje të përshtatshme për ruajtje dhe dëgjim ose nëpërmjet një transkripti të plotë. Në rast transkriptimi, sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.
2. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të paregjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të paregjistruara, biseda përshkruhet me shkrim në mënyrë të detajuar nga njësia përgjegjëse. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.
3. Kur sinjalizimi bëhet verbalisht gjatë një takimi me njësinë përgjegjëse ose me autoritetin kompetent, sinjalizimi dokumentohet me pëlqimin e sinjalizuesit nëpërmjet regjistrimit zanor ose nëpërmjet hartimit të një procesverbali të takimit. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e dokumentuar, duke nënshkruar përkatësisht regjistrimin ose procesverbalin.

Neni 8

Njësia përgjegjëse

1. Administrimi dhe trajtimi i sinjalizimeve kryhet nga njësia përgjegjëse, e caktuar me urdhër të Ministrit të Arsimit.
2. Sipas përcaktimeve të vendimit të KM nr. 395, datë 28.05.2026, njësia përgjegjëse përbëhet nga drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe një specialist auditues. Në mungesë të drejtuesit, ajo përbëhet nga dy punonjës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Njësia ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
3. Njësia përgjegjëse ka këto detyra:
 - a) Merr, regjistron dhe administron sinjalizimet;
 - b) Siguron ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të informacionit të raportuar;
 - c) Kryen verifikimin paraprak dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, në përputhje me ligjin;
 - ç) Ndjek afatet procedurale të parashikuara nga ligji nr. 96/2025;
 - d) Dokumenton çdo veprim procedural me procesverbal;
 - e) Bashkëpunon me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, sipas rastit;
 - f) Përgatit dhe paraqet pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, në përputhje me nenin 14, pika 12, të ligjit nr. 96/2025.

4. Anëtari i njësisë përgjegjëse nuk duhet të trajtojë sinjalizimin kur ka interes personal, familjar apo profesional në çështjen objekt shqyrtimi.

Anëtari i njësisë përgjegjëse ka detyrimin të deklarojë menjëherë ekzistencën e çdo rrethane që mund të krijojë konflikt interesi dhe të kërkojë përjashtimin nga trajtimi i çështjes.

Në rast konflikti interesi, pamundësie objektive ose mungese të përkohshme të njërit prej anëtarëve, Ministri cakton me urdhër një zëvendësues për periudhën përkatëse.

5. Në çdo rast, ndryshimi i përbërjes së njësisë përgjegjëse i njoftohet ILDKPKI-së.

Neni 9

Regjistri i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm fizik ose elektronik, të ndarë nga regjistri i zakonshëm i protokollit dhe me akses vetëm nga punonjësit e autorizuar të njësisë përgjegjëse.

Regjistri i posaçëm përmban të paktën datën e regjistrimit të sinjalizimit, numrin rendor, mënyrën e paraqitjes së tij, statusin e shqyrtimit dhe datën e përfundimit të procedurës, pa përfshirë të dhëna që mund të identifikojnë sinjalizuesin.

2. Njësia përgjegjëse, nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:

- a) sinjalizimi, me përjashtim të rasteve të sinjalizimit anonim, nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
- b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 96/2025;
- c) nga përmbajtja e sinjalizimit dhe nga verifikimi paraprak, rezulton qartazi se mungojnë elementet përbërës të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

2. Vlerësimi për mos fillimin e hetimit kryhet nga nëpunësit përgjegjës të kësaj njësie.

3. Vlerësimi i arsyetuar për mos fillimin e hetimit administrativ i përcillet sinjalizuesit pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e këtij të fundit.

Neni 11

Verifikimi paraprak

1. Njësia përgjegjëse kryen verifikim paraprak, për të verifikuar nëse nga përmbajtja e tij ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se informacioni i sinjalizuar përmban elemente të një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.

Verifikimi paraprak kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të sinjalizimit.

Gjatë verifikimit paraprak, njësia përgjegjëse mund të kërkojë dokumente ose informacione shtesë kur kjo është e nevojshme për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për fillimin e hetimit administrativ.

2. Kur konstaton indicie për veprime hakmarrëse ose rrezik të kryerjes së tyre, njësia përgjegjëse informon menjëherë sinjalizuesin për të drejtën e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje pranë ILDKPKI-së dhe, sipas rastit, ia përcjell çështjen këtij autoriteti, duke ruajtur konfidencialitetin.
3. Masat për mbrojtjen e sinjalizuesit nga hakmarrja zbatohen sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe rregullohen në mënyrë të detajuar me akt të veçantë të ILDKPKI-së.

Neni 12

Detyrimi i personit të paautorizuar

1. Nëse sinjalizimi merret nga një punonjës që nuk është pjesë e njësisë përgjegjëse, ai duhet:
 - a) ta përcjellë menjëherë te njësia përgjegjëse;
 - b) të mos mbajë kopje;
 - c) të ruajë identitetin dhe konfidencialitetin;
 - d) të mos e regjistrojë në protokollin e zakonshëm.

Neni 13

Shqyrtimi dhe hetimi administrativ i sinjalizimit

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 96/2025. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Procedura e hetimit administrativ përfundon sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e fillimit të saj, në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 96/2025.
3. Gjatë hetimit administrativ, njësia përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë dokumente, informacione, shpjegime ose deklarata nga çdo strukturë e Ministrisë së Arsimit dhe nga institucionet e varësisë për të cilat ushtron kompetencat e saj, duke garantuar në çdo rast mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit.
4. Në hetimin administrativ mund të marrë pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë edhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.

5. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe:
 - a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit, me përjashtim të të dhënave të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e tij, të cilat paraqiten në mënyrë anonime;
 - c) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
6. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, njësia është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
7. Ministria e Arsimit merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi i kundërligjshëm i sinjalizuar.
8. Sinjalizuesi duhet të informohet për ecurinë dhe rezultatin përfundimtar jo më vonë se 3 (tre) muaj nga konfirmimi i regjistrimit, edhe kur konfirmimi nuk është dërguar.

Neni 14

Provat në hetimin administrativ

1. Njësia përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë.
2. Njësia përgjegjëse mund të kërkojë dokumentacion dhe të dhëna shtesë, të mbledhë deklarata, të marrë në pyetje persona që kanë dijeni për çështjen, të kërkojë kryerjen e inspektimeve ose analizave dhe, kur është e nevojshme, të propozojë angazhimin e ekspertëve të jashtëm.
3. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e njësisë përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Në fund të hetimit hartohet akt konstatimi ose procesverbali, i cili nënshkruhet nga punonjësit e njësisë përgjegjëse dhe zyrtarët e ministrisë/institucioneve të varësisë, në cilësinë e palëve nënshkruese. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime, brenda 5 (pesë) ditëve pune. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen akt konstatimit/procesverbalit.
Kur një punonjës refuzon të nënshkruajë akt konstatimin ose procesverbalin, refuzimi dhe kur deklarohen arsyet e tij, pasqyrohen në dokument. Refuzimi për nënshkrim nuk çënon vlefshmërinë e dokumentit.
5. Pas përfundimit të afatit prej 5 (pesë) ditëve pune, njësia përgjegjëse përgatit raportin

e arsyetuar, në të cilin pasqyrohet çdo veprim procedural, i dokumentuar gjatë procedurës së hetimit administrativ.

Neni 15

Pjesëmarrja e sinjalizuesit gjatë hetimit administrativ

1. Gjatë hetimit administrativ të sinjalizimit, sinjalizuesi mund të thirret për t'u paraqitur nga njësia përgjegjëse apo të paraqitet me kërkesë të tij për të dhënë shpjegime apo akte provuese shtesë që janë të nevojshme për hetimin.
2. Kur sinjalizimi është anonim, paraqitja e shpjegimeve apo akteve provuese kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që përmbushin garancitë për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit.

Neni 16

Pjesëmarrja e të sinjalizuarit gjatë hetimit administrativ

1. Personi i sinjalizuar apo personat e përfshirë, marrin pjesë në procesin e hetimit administrativ kur pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
2. Në rastet kur njësia përgjegjëse vlerëson se thirrja e të sinjalizuarit apo personave të përfshirë mund të përbëjë rrezik për fshehjen, prishjen apo asgjësimin e provave, njoftimi mund të kryhet pas sigurimit të provave sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi është i bazuar, duke referuar çështjen menjëherë në autoritetin kompetent kur përmban elemente të kundërvajtjes administrative ose në organet e prokurorisë, kur ekziston dyshimi për kryerjen e një vepre penale;
 - b) sinjalizimi rezulton i pabazuar në fakte dhe të dhëna;
 - c) rezulton se sinjalizuesi ka paraqitur me dashje informacion të rremë ose të pasaktë; në këtë rast njësia përgjegjëse evidenton faktin dhe referon çështjen sipas kompetencës, pa cenuar përgjegjësitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Referimi i çështjes pranë organit kompetent në zbatim të pikës 1, germa a, të këtij neni, bëhet duke ruajtur anonimitetin e sinjalizuesit dhe pa zbuluar të dhëna që mundësojnë identifikimin e tij.
3. Vendimi i arsyetuar për mos fillimin ose përfundimin e hetimit i përcillet sinjalizuesit në çdo rast, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë, së bashku me informacionin për mjetet juridike që mund të ushtrohen sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në dosjen e sinjalizimit shënohet vlerësimi i arsyetuar për përfundimin e hetimit administrativ, ku pasqyrohen të gjitha shkaqet që kanë çuar në këtë vlerësim, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.
5. Në dosjen e sinjalizimit do të administrohen këto dokumente:
 - a) sinjalizimi;
 - b) konfirmimi i marrjes së sinjalizimit;
 - c) dokumentacioni i verifikimit paraprak;
 - d) aktet e konstatimit ose procesverbalet;
 - e) provat e administruara;
 - f) korrespondenca zyrtare;
 - g) raporti i arsyetuar;
 - h) vlerësimi për mos fillimin ose përfundimin e hetimit administrativ;
 - i) njoftimet drejtuar sinjalizuesit;
 - j) kërkesat, shkresat e referimit dhe çdo korrespondencë e zhvilluar me organet kompetente administrative, disiplinore, inspektuese ose të ndjekjes penale, kur rasti është përcjellë për shqyrtim të mëtejshëm;
 - k) çdo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin, hetimin administrativ dhe trajtimin e sinjalizimit.

Neni 18

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit i bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Identiteti i personit të përfshirë, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të, ruhet dhe mbrohet në kushte konfidencialiteti nga njësia përgjegjëse.
3. Njësia përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorë për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 96/2025.
4. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara, sipas pikës 1 të këtij neni, lejohet vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar e proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor.
5. Njësia përgjegjëse njofton me shkrim sinjalizuesin, mbi arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm, përveç rasteve kur një informim i tillë do të rrezikonte hetimin ose procedimin gjyqësor.
6. Punonjësit e njësisë përgjegjëse dhe çdo person që vihet në dijeni të informacionit të mbrojtur gjatë procedurës së sinjalizimit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të funksionit ose marrëdhënies së tyre të punës.

Neni 19

Standardet e konfidencialitetit në ushtrimin e të drejtës për njohjen me dosjen

1. Çdo e dhënë e dosjes së hetimit administrativ që mund të çojë në identifikimin e sinjalizuesit, përfshirë të dhënat personale të tij, u vihen në dispozicion palëve të treta vetëm në mënyrë të anonimizuar, duke garantuar ruajtjen e anonimitetit të sinjalizuesit.
2. Çdo dokument që përmban të dhëna për procedurën e hetimit administrativ dhe gjetjet mbi sinjalizimin vihen në dispozicion të palëve të treta vetëm në formë të anonimizuar.

Neni 20

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 96/2025. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.
2. Në rast se të dhënat personale, që nuk konsiderohen të nevojshme për hetimin mbledhen rastësisht, ato fshihen menjëherë dhe nuk përfshihen në hetimin administrativ.
3. Në rastet kur, gjatë zbatimit të ligjit nr. 96/2025 dhe kësaj Rregulloreje, konstatohen shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 21

Ruajtja e të dhënave dhe administrimi i dokumentacionit

1. Njësia përgjegjëse siguron gjurmueshmërinë e të dhënave e të informacionit, si dhe ruan dokumentacionin e krijuar në formë shkresore ose elektronike, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin e mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personave të përfshirë.
2. Dokumentacioni origjinal ruhet për 5 (pesë) vjet nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur është në zhvillim një procedurë administrative, gjyqësore ose penale që lidhet me të.
3. Dokumentacioni elektronik ruhet në mjedise të sigurta teknologjike, me akses të kufizuar vetëm për personat e autorizuar, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.
4. Pas përfundimit të afatit të ruajtjes, dokumentacioni arkivohet sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe administrimin e dokumenteve zyrtare.

Neni 22

Interpretimi dhe zgjidhja e rasteve të paparashikuara

Për çështjet që nuk rregullohen shprehimisht në këtë rregullore zbatohen dispozitat e ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të legjislacionit tjetër përkatës në fuqi.

Neni 23

Raportimi periodik dhe monitorimi

Njësia përgjegjëse monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe propozon përmirësime të procedurave të brendshme, kur evidentohet nevoja për harmonizim me ndryshimet ligjore ose me rekomandimet e ILDKPKI-së.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit me urdhër të Ministrit të Arsimit.